



Programi i Investimeve Sociale dhe Mjedisore 2017



“Dëshirojmë të falënderojmë TAP-in për dhurimin e një mjeti që trajton nevojat tona faktike dhe jep kontribut të rëndësishëm për realizimin e qëllimeve dhe veprimtarive tona.”

Ioanna Hatzivariti
Presidente e qendrës së bamirësisë “Pnoe” në Kavalla
(Shoqata për Fëmijën dhe Nënëen)

“Dëshiroj të përgëzoj TAP-in për këtë nismë shumë të rëndësishme, duke qenë se ky në vetvete është një projekt shumë i rëndësishëm për Greqinë Veriore dhe të gjithë vendin në përgjithësi.”

Apostolos Tzitzikostas
Kryetar i Prefekturës së Maqedonisë Qendrore

“TAP-i i sjell bekime bashkive, ku ai kalon.”

Anestis Aggelis
Kryetari i Bashkisë së Kastorias

“Nuk besoj se ka një shoqëri apo donator tjetër që mund të krahasohet me TAP-in për këto investime sociale të bëra për brezat e ardhshëm.”

Gazmend Toska
Mësues në Shkollën “7 Dëshmorët”

“Unë i jam mirënjohës TAP-it dhe AADF-së për vëmendjen e tyre të veçantë kushtuar Çorovodës dhe ndihmesën e dhënë për përmirësimin e infrastrukturës sonë turistike.”

Nesim Spahiu
Kryetar i Bashkisë Skrapar

“Puna me TAP-in më mësoi se çfarë është një projekt i vërtetë i një gazsjellësi: do të thotë të punosh me një ekip profesional të përkushtuar ndaj sigurisë, plot respekt për mjedisin, që mbron trashëgiminë kulturore dhe që ndërton një projekt kompleks brenda afateve.”

Megys Mustafa
Raundi i Parë i Programit të Praktikave Profesionale në TAP

“Kursi i Masterit ishte shumë i dobishëm për mua. Sot mund të përdor teknika gatimi, receta dhe produkte që nuk i njihja më parë. Kursi ka qenë me dobi edhe për të ‘edukuar’ klientët e mi.”

Restoranti La Bella Vita
Carmiano (Leçe)

“Jam shumë i kënaqur. Kam mësuar shumë gjëra të reja për menaxhimin dhe kuzhinat e restoranteve. Shënimet që kam marrë i mbaj me kujdes.”

Restoranti Lu Oriu
Santa Cesarena Terme (Leçe)

“Një përvojë shumë e mirë që më ndihmoi të njihem me persona të aftë dhe të mrekullueshëm. Kam zgjeruar rrjetin tim profesional dhe kam filluar të gatuj me më shumë respekt për produktet dhe zonën përreth.”

Ferma Li Curti Manor
Caprarica (Leçe)

Përmbajtja

06 Hyrje

08 Programi ISM në Greqi

- 12 Financimi i Programeve të Masterit në fushën e energjisë
- 16 Dhurimi i Mjeteve për Shërbimet Komunale në Greqinë Veriore
- 18 Nisja e Programit Bujqësor Tematik "Toka e Begatë"
- 22 Grante dhe Donacione në Shumën mbi 580.000 Euro
- 24 Rizhvillimi i Rrugës Darilaiou në sheshin qendror të Serres
- 26 Financimi i Studimeve të Administrimit të Pyjeve në Nestorio
- 27 Lehtësimi i Aksesit në Plazh për Personat me Aftësi të Kufizuara në Avdira dhe Dhurimi i Pajisjeve të Pastrimit
- 28 Sponsorizimi i Seminareve për Sigurinë Rrugore në Shkolla
- 30 Mbështetje për Shërbimet e Emergjencës dhe të Shpëtimit në Greqi

32 Programi ISM në Shqipëri

- 36 Rinovimi i ambienteve sportive të Shkollës në Fier
- 37 Rikonstruksioni i Shkollës "7 Dëshmorët" në Roskovec
- 40 Rikonstruksioni i Shkollës "Fuat Babani" në Bilisht
- 42 Rikonstruksioni i Shkollës "Thanas Ikonomi" në Greçalli, Fier
- 46 Sponsorizimi i Programit të Sigurisë dhe Shëndetit në Rrugë
- 48 Sigurimi i pajisjeve për shërbimet e Emergjencave të Zjarrit
- 50 Ndërtimi i Urës me Dy Korsi në Çorovodë
- 52 Ndërtimi i Platformave Panoramike mbi Kanionet e Osumit
- 54 Nisja e Programit të Praktikës Profesionale
- 55 Ndihmesa për Familjet në Nevojë për Shkak të Motit të Keq në Otlak
- 56 Ndihmesa për 1.300 Familje në Nevojë për Shkak të Motit të Keq

58 Programi ISM në Itali

- 62 TAP Start: Grante për Organizatat Vendore
- 64 Mena: Trajnimi për Menaxhim Restoranti
- 68 Reduktimi i Ndotjes Detare – Libera il Mare
- 70 Akademia TAP: kurse trajnimi falas për komunitetet vendase

Qëllimi i Programit të TAP-it për Investimet Sociale dhe Mjedisore (ISM) është dhënia e kontributit për përmirësimin e jetesës dhe cilësisë së jetës në komunitetet vendase pranë Projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP), në mënyrë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Objektivat e përgjithshëm të Programit ISM të TAP-it janë:

- të përmirësojë jetesën në komunitetet vendase;
- të mbështesë përmirësimin e cilësisë së jetesës përgjatë gjurmës së gazsjellësit;
- të bëjë të mundur përmirësimin e aftësive dhe aftësive përmes mbështetjes për nismat e arsimit dhe formimit; dhe
- të fuqizojë menaxhimin mjedisor, përfshirë mbështetjen për biodiversitetin.

Këto fusha janë përzgjedhur pas një analize të Vlerësimeve të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS), duke identifikuar në mënyrë specifike ato fusha ku ISM mund të mbështesë menaxhimin e rreziqeve sociale, si dhe të gjenerojë vlera, si për TAP-in ashtu edhe për komunitetet e tij pritëse. Krahas kësaj, secili nga vendet pritëse ka përparësi të ndryshme për zhvillim dhe rreziqe të ndryshme sociale. Këto fusha janë përcaktuar qëllimisht të kenë nivel të lartë, për t'i lejuar çdo vendi të punojë në kuadrin e tij, ndërkohë që i përgjigjet edhe kontekstit të vet të brendshëm.

TAP-i ka dhënë më shumë se 55 milionë Euro posaçërisht për projektet ISM në Greqi, Shqipëri dhe Itali.

Ndërkohë që pritet që disa nga projektet të përfundojnë gjatë fazës fillestare të operacioneve, qëllimi është që shumica e investimeve të kryhen gjatë fazës së ndërtimit.



Programi ISM në
GREQI



TAP-i investon, dhe do të vazhdojë të investojë, në veprimtari që kanë një ndikim të fuqishëm social dhe mjedisor në Greqinë Veriore, duke mbështetur projekte të zbatuara në të gjitha Prefekturat Greke të përshkuara nga gazsjellësi, Maqedonia Perëndimore, Maqedonia Qendrore dhe Maqedonia Lindore – Traka.

Programi vullnetar i TAP-it për Investimet Sociale dhe Mjedisore (ISM) në Greqi arrin në një vlerë të përgjithshme prej 32 milionë Euro dhe përqendrohet në katër shtylla:

- Mjedis
- Arsim dhe formim
- Zhvillim socio-ekonomik, me përqendrim në bujqësi dhe turizëm
- Cilësi e jetës së komunitetve vendase, me përqendrim në mbështetjen dhe kohezionin shoqëror.

Përfaqësuesit e TAP-it dialogojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të hapur me komunitetet vendase dhe të gjitha nivelet e qeverisjes – qendër, prefekturë dhe bashki – për të hartuar projekte ISM të rëna dakord në mënyrë të ndërsjellë, të cilat mbështesin përparësitë e zhvillimit të vetë komunitetit.

Shihni në vijim projektet kyçe ISM të zbatuara në Greqi në kuadrin e programit ISM të TAPit. Kjo është një përzgjedhje pasqyruese e nismave të ndryshme që TAP-i ka ndërmarrë, të cilat japin kontribut për çështje shoqërore, humanitare dhe të tjera me rëndësi.



0.1 Financimi i Programeve Master në Fushën e Energjisë



Trans Adriatic Pipeline | Αγωγός Καλής Ενέργειας
ΠΡΟΓΡΑΜΜΑ ΕΚΕ



TAP-i po ndihmon në arsimin e brezit të ardhshëm të ekspertëve të energjisë, duke financuar dy Programe Master të ofruara nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore dhe Instituti e Edukimit Teknologjik i Maqedonisë Perëndimore. Gjatë një periudhe prej pesë vitesh, TAP-i do të investojë 1 milion Euro për këtë nismë, nëpërmjet një donacioni për Fondacionin Bodossaki. Shuma në fjalë do të shfrytëzohet kryesisht për të subvencionuar tarifën e shkollimit të studentëve. Në kuadrin e kërkesave me rëndësi, TAP-i po mbështet financiarisht:

- Programin 4-semestral "Menaxhimi dhe transporti i naftës dhe gazit", ofruar nga Departamenti i Administrimit të Biznesit dhe Departamenti i Inxhinierisë Mjedisore dhe Kontrollit të Ndotjes në Institutin e Edukimit Teknologjik të Maqedonisë Perëndimore, në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të Ekonomisë të Azerbajxhanit; dhe
- Programin 3-semestral "Teknologjitë dhe Menaxhimi i Energjisë", ofruar në Departamentin e Inxhinierisë Mekanike në Universitetin e Maqedonisë Perëndimore.

Projekti ISM ka si qëllim të promovojë arsimin dhe kërkimin shkencor, si dhe të përmirësojë aftësimin dhe aftësitë në një sektor strategjik me zhvillim të vazhdueshëm, siç është energjia. Të dy kurset përqendrohen në gazin natyror, si dhe menaxhimin e hidrokarbureve të tjera fosile dhe burimeve të energjisë së rinovueshme. Duke subvencionuar të paktën 50% të tarifës së shkollimit të secilit student për të dy programet, TAP-i i bën më të aksesueshëm kurset e ofruara.

Palë kyçe interesi nga zona i kanë mbështetur këto nisma, duke përfshirë:

- Kryetarin e Prefekturës së Maqedonisë Perëndimore Theodoros Karypidis
- Kryetarët e tre bashkive në Maqedoninë Perëndimore, përkatësisht Anestis Aggelis nga Bashkia e Kastorias, Panagiotis Kepaptsoglou nga Bashkia Argos Orestiko dhe Paschalis Gketsios nga Bashkia e Nestorios
- Profesor Evangelos Siskos nga Instituti i Edukimit Teknologjik në Maqedoninë Perëndimore
- Profesor Yannis Bakouros nga Universiteti i Maqedonisë Perëndimore

Të dy programet do të financohen për 5 vjet. Kontributi i TAP-it arrijnë në vlerën e 100.000 Eurove në vit për secilin program pasuniversitar.

Këto dy programe të nivelit Master mund të pranojnë 90 studentë në vit:

- 50 studentë në Institutin e Edukimit Teknologjik të Maqedonisë Perëndimore dhe
- 40 studentë në Universitetin e Maqedonisë Perëndimore.





0.2 Dhurimi i Mjeteve të Shërbimeve Komunale në Greqinë Veriore



DESTINACIONI, SIGURIA

Dhurimi i Mjeteve të Shërbimeve Komunale

Në qershor të vitit 2017, TAP-i nisi një program Investimi Mjedisor dhe Social (ISM) me vlerë rreth 1 milion Euro, që lidhej me dhurimin e 93 mjeteve të shërbimeve komunale, përfshirë ambulanca, borëpastruese dhe mjete për largimin e mbetjeve. Nga ky investimi përfitojnë komunitetet vendase në të tre prefekturat e Greqisë Veriore të përshkuara nga tubacioni: Maqedonia Perëndimore, Maqedonia Qendrore dhe Maqedonia Lindore – Traka.

Këto 93 mjete përbëhen nga 33 ambulanca, 23 mjete për largimin e mbetjeve dhe fshirëse, 20 mjete pyjore, 14 borëpastruese dhe 3 mjete të mbrojtjes civile. Programi përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së jetës së komuniteteve, si dhe menaxhimin mjedisor.

Projekti u hartua në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë Greke, si dhe me autoritetet në nivel prefekturë dhe në nivel vendor, për t'i shërbyer nevojave të komuniteteve në Greqinë Veriore, për të ofruar kujdes shëndetësor, menaxhimin mjedisor, shërbime pastrimi dhe sigurie më cilësore për banorët e zonave.

Nisma u bë fillimisht publike gjatë një Konference për Shtyp të mbajtur në Selanik, ku morën pjesë tre Kryetarët e Prefekturave të Greqisë Veriore dhe disa kryetarë bashkie si përfaqësues të komuniteteve që po përfitonin nga kjo nismë. Ky aktivitet ishte gjithashtu edhe transmetimi i parë për publikun i fushatës së TAP-it për fillimin e kësaj nisme të veçantë me sloganin "TAP. Një gazsjellës i energjisë së mirë".



0.3 Fillimi i Programit Bujqësor Tematik “Tokë e Begatë”



TOKË E BEGATË
Mbështetje për Arsimin në
Agro-Ushqim



Nisma bujqësore “Tokë e Begatë / Mbështetje për Arsimin në Agro-Ushqim” do të zbatohet në të tre Prefekturat e Greqisë Veriore të përshkuara nga TAP-i. Ky është një investim prej rreth 1 milion Euro që zbatohet në të gjitha prefekturat për veprimtari arsimore dhe bioteknologjike, që kanë si synim kultivimin, tregtimin dhe shitjen e produkteve agroushqimore ose varieteteve të prodhuara në zonë përgjatë gjurmës së tubacionit, si mjalti dhe produktet e bletës, ulliri dhe vaji i ullirit, bimët medicinale dhe aromatike, bathët, frutat, pemitezi (melasë kallam sheqeri), specat, produkte blegtorale (nga dhia, delja dhe lopa). Këto produkte u përzgjedhën për shkak të origjinës në vende të përshkuara nga TAP-i, tiparet e tyre të veçanta dhe konkurruese, dhe potencialin e tyre për rritje dhe tregtim.

Nisma “Tokë e Begatë” është pjesë e Programit të Investimeve Sociale dhe Mjedisore (ISM) me vlerë prej 32 milionë Euro që Projekti po zbaton vullnetarisht në zonat përgjatë gjurmës së gazsjellësit. Kjo nishtë sjell përfitime për rreth 300 prodhues individualë dhe 70 njësi prodhimi, ndërkohë që pritet të sjellë përfitime të shumta për komunitetet bujqësore në Greqinë Veriore, duke qenë se:

- nxit bashkëpunimin midis prodhuesve dhe shkencëtarëve
- përqendrohet te prodhimet vendase
- identifikon karakteristikat e tyre unike, krijon “identitetin” e tyre gjenetik, duke bërë të mundur kështu autentifikimin, certifikimin dhe gjurmimin e tyre
- mundëson të gjitha të dhënat shkencore përkatëse për çdo palë të interesuar.

Projekti do të monitorohet nga Fondacioni Bodossaki dhe do të zbatohet nga American Farm School Selanik (AFS) dhe Instituti për Bioshkenat e Zbatuara (INAB) i Qendrës për Kërkim dhe Teknologji Hellas (CERTH). AFS do t'i ofrojë përfituesve seminare edukative, si dhe këshillim të personalizuar për metodat më të mira të kultivimit, fertilizimit, përdorimit të makinerive, etj. INAB do të mbledhë kampionë të produkteve për të identifikuar karakteristikat dhe cilësitë e tyre të veçanta, duke regjistruar më pas “identitetin e tyre gjenetik”, për të promovuar vlerën e tyre të shtuar në Greqi dhe jashtë saj.





0.4 Grante dhe Donacione me Vlerë mbi 580.000 Euro

TAP-i ka si qëllim të jetë fqinj i mirë në komunitet pritëse të gazsjellësit, veçanërisht kur bëhet fjalë për personat në nevojë dhe për pjesëtarët më të cenueshëm të shoqërisë. Gjatë këtyre viteve, TAP-i ka siguruar më shumë se 580.000 Euro në formë grantesh dhe donacionesh për një sërë organizatash në Greqinë Veriore. Që prej majit të vitit 2016, TAP-i ka nisur gjithashtu një partneritet me Rrjetin e Solidaritetit Social (NSS) që specializohet në këtë fushë.

Që prej vitit 2014, TAP-i ka mbështetur më shumë se 20 institucione dhe shoqata që gjenden në të tre Prefekturat e përkrahura nga gazsjellësi. Ndër të tjera ato janë:

- Fshati i Fëmijëve SOS Aristino (Alexandroupolis, Trakë)
- Fshati i Fëmijëve në Filyro (Selanik)
- OJF-ja "Keletron, Love for Children"
- Njësia e Lëvizshme e Parandalimit të Kancerit të Gjirit, në bashkëpunim me spitalin Theagenio, në Selanik
- Institutin "Agia Marina" në Kavalla për fëmijët me nevoja të veçanta
- "Strehën e Fëmijëve" në Selanik
- Qendrën për Veprimtari Krijuese të Fëmijëve në Serres
- Institutin për mbrojtjen e fëmijëve me autizëm në Kastoria
- Qendrën Speciale "Stavros Halioris" në Ksanthi
- Shtëpinë e të Moshuarve "Athina dhe Lazaros Rizos" në Kastoria
- Shoqatën e Prindërve dhe Miqve të Personave me Autizëm në Eordaia
- Shoqatën "Pnoe" në Kavalla
- Markatën Sociale të Bashkisë Amyntaio
- Shoqatën e PAK "Agioli Theodoroi" në Komotini
- Shoqatën e Prindërve dhe Miqve të Personave me Autizëm "Agios Vasileios" në Alexandroupolis
- Qendrën për Mirëqenie dhe Solidaritet të Bashkisë së Komotinisë

Këto donacione kanë bërë të mundur blerjen e pajisjeve të zyrës dhe shtëpisë; mobilieve dhe pajisjeve elektronike; pajisjeve mjekësore dhe të rehabilitimit; mjeteve të specializuara të transportit; rikonstrukcioneve të ndërtesave dhe furnizimeve ushqimore.



0.5 Rizhvillimi i Rrugës Darilaiou në sheshin qendror të Serres



PUNIME FRYMËZUESE

Zhvillimi i Infrastrukturës Vendase

Me qëllim trajtimin e nevojave të komuniteti për hapësira publike të sigurt, të hapura dhe të aksesueshme, TAP-i rihvilloi ish Rrugën Dorilaiou në Sheshin Qendror të Serres. Investimi prej 248.000 Euro përfshiu: shtrimin e rrugës dhe trotuareve, ndërtimin e korsive të çiklizmit, vendosjen e stolave, çezmave, shtyllave të ndriçimit, etj. Projekti është pjesë e programit të TAP-it "Punime Frymëzuese / Zhvillimi i Infrastrukturës Vendore" që po zbatohet në të tre Prefekturat e përshkuara nga gazsjellësi.

Projekti i rihvillimit u mirëprit nga bashkia dhe komuniteti vendor si një mundësi për të rjetëzuar qendrën historike dhe tregtare të Serres. Falë përpjekjeve të të gjitha palëve të përfshira, projekti u përmbyll në vetëm tre muaj pas nisjes së tij, dhe u zbatua në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare për Shëndetin dhe Sigurinë.

Sheshi Qendror është i vendosur në zemër të qytetit të Serres me një sipërfaqe prej 70.000 m². Rruga e rihvilluar rishtazi përmirëson cilësinë e jetës së banorëve dhe vizitorëve, duke i siguruar atyre një zonë të bukur zbatimjeje për ecje dhe çiklizëm.

Faktikisht, rihvillimi i Rrugës Dorilaiou, hapi i parë në një projekt më të gjerë për rihvillimin e të gjithë parkut qendror të qytetit – "një projekt rihvillimi me rëndësi për banorët e Serres dhe një vizion për 100 vitet e ardhshme të qytetit që po bëhet realitet," siç u theksua nga Kryetari i Bashkisë së Serresit, Petros Aggelidis.

Projekti i rihvillimit të Rrugës Dorilaiou përfshiu:

- shtrimin e rrugës dhe trotuareve që çonin në një hanz ekzistues me gurë rreshpe nga Karystos dhe elementë dekorativë
- krijimin e një rruge çiklizmi me dy kalime
- shtrimin e elementëve të prekshëm për personat e aftësi të kufizuara në shikim
- instalimin e një rrjeti ndriçimi dhe shtyllave të ndriçimit
- instalimin e stolave të jashtëm dhe dy çezmave me ujë të pijshëm të nderuara me pllaka guri.



0.6 Financimi i Studimeve të Menaxhimit të Pyjeve në Nestorio

Shpallur në qershor të vitit 2017, ky është një projekt financues për hartimin e pesë Studimeve të Menaxhimit të Pyjeve në Bashkinë Nestorio. Projekti mbështet jetesën e rreth 3.000 banorëve të zonës, duke qenë se puna kërkimore do t'u mundësojë atyre vazhdimin e veprimtarisë së qëndrueshme të prodhimit të lëndës drusore dhe praktikave të tjera pyjore. Studimet do të sigurojnë edhe menaxhimin e duhur nga pikëpamja mjedisore, me përfitim shoqëror dhe të qëndrueshëm ekonomikisht të pyjeve për brezat aktualë dhe të ardhshëm.

Bashkia Nestorio nuk kishte mundësi të autorizonte Studime të reja të Menaxhimit të Pyjeve pas skadimit të afatit të studimeve të mëparshme në vitin 2016. Këto studime janë të nevojshme për praktikën pyjore, sepse ato specifikojnë modelet e menaxhimit të pyjeve që duhen zbatuar dhe volumin e pritshëm të lëndës drusore që duhet të pritet në kohë dhe vende të caktuara.

Si rrjedhojë, Studimet e përditësuara të Menaxhimit të Pyjeve në Nestorio janë jetike, në mënyrë që vendasit të kenë mundësi të vazhdojnë prodhimin e qëndrueshëm të lëndës drusore. Këto studime do të jenë të vlefshme për të paktën 10 vjet. Këto studime, përveç sigurimit të jetesës së banorëve vendas, do të japin kontribut për menaxhimin e mirë mjedisor dhe për promovimin e zhvillimit rajonal.

Shpallja e donacionit nga TAP-i u mirëprit nga komuniteti vendas. Kryetari i Bashkisë Nestorio, Z. Paschalis Getsios, theksoi nevojën dhe rëndësinë e projektit, duke qenë se ai siguron punë për druvarët, transportuesit dhe drejtuesit e kamionëve, ndërkohë që rrit edhe të ardhurat e bashkisë.



0.7 Lehtësimi i Aksesit në Plazh për Personat e Aftësi të Kufizuara në Avdira dhe Dhurimi i Pajisjeve të Pastrimit

Me qëllim përmirësimin e jetesës së banorëve të Avdirës, gjatë verës së vitit 2017, TAP-i ndihmoi me ndërtimin e një rampe të veçantë SEATRAC, për të lehtësuar aksesin në plazh për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK). Për më tepër, TAP-i dhuroi pajisje për pastrimin e zonës bregdetare përreth dhe përmirësimin e administrimit mjedisor të zonës. Investimi u zbatua nga partneri i TAP-it, Rrjeti për Solidaritet Social, dhe arriti një vlerë prej më shumë se 100.000 Euro.

Mekanizmi SEATRAC u instalua në plazhin "Leukippos" në Avdira, në afërsi të Shkollës së Arsimit dhe Formimit Profesional për Persona me Aftësi të Kufizuara, shkollë për PAK, si dhe shkollë e specializuar për të verbrit.

Mekanizmi përbëhet nga një ndenjësë që lëviz mbi një shinë, duke i lejuar kështu personave me vështirësi në lëvizje të notojnë në det të pavarur ose me ndihmën e një kujdestari. TAP-i, për të pasur një ndikim gjithëpërfshirës, ndihmoi gjithashtu me ndërtimin e një vendkalim prej druri, e dhomave të zhveshjes dhe dusheve.

Këto nisma kanë si qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës për PAK-ët, si dhe administrimin mjedisor në një kuadër më të gjerë. Kryetari i Bashkisë Avdira, Giorgos Tsitiridis, si dhe përfaqësues të shoqatave vendore të PAK-ëve falënderuan TAP-in për realizimin e një projekti shumë të nevojshëm komunitetin e tyre, një projekt ky që promovon përfshirjen dhe integrimin social, si dhe bukurinë natyrore të zonës.



0.8 Sponsorizimi i Seminareve për Sigurinë Rrugore në Shkolla

Në periudhën maj 2016 deri mars 2017, TAP-i sponsorizoi një program Seminaresh për Sigurinë Rrugore, ku morën pjesë më shumë se 25.000 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme në të tre Prefekturat e Greqisë Veriore të përshkuara nga gazsjellësi: Maqedonia Perëndimore, Maqedonia Qendrore dhe Maqedonia Lindore – Traka. Siguria është përparësia Nr. 1 e TAP-it dhe duke mbështetur këtë projekt, TAP-i promovon praktikën jetike të sigurisë rrugore që në moshë të hershme.

Programi i Seminareve për Sigurinë Rrugore u organizua dhe zbatua nga Instituti Helen i Transportit (IMET/EKETA), me pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve nga më shumë se 142 shkolla fillore dhe 60 shkolla të mesme. Seminaret dyorëshe u dhanë nga 36 instruktorë, inxhinierë transporti dhe ekspertë arsimit, që përdorën materiale të përshtatura arsimore për secilën grupmoshë.

Fëmijët më të vegjël mësuin rregullat bazë të sigurisë, si përdorimi e rrugës si këmbësorë, çiklistë, apo pasagjerë, ndërsa adoleshentët mësuin rregullat dhe rregulloret që duhet t'i kenë parasysh si drejtues të ardhshëm të mjeteve të motorizuara.

TAP-i mbështeti projektin në kontekstin e angazhimit të tij për përputhshmëri me standardet dhe praktikat më të mira të shëndetit dhe sigurisë, të pranuar ndërkombëtarisht.

Meritat e programit për studentët që morën pjesë në seminare dhe për shoqërinë në përgjithësi u theksuan nga Drejtorja Kërkimore e IMET/EKETA, Dr. Georgia Ayfantopoulou, që e falënderoi TAP-in për bashkëpunimin dhe mbështetjen.

Në të njëjtin kontekst, palët vendore të interesit përgëzuan përpjekjet e TAP-it për t'u angazhuar dhe bashkëpunuar me komunitetet e prekura nga projekti dhe për të ndërgjegjësuar nxënësit rreth lëvizjes së sigurt dhe të përshtatshme të përditshme në rrugë.



0.9 Mbështetje për Shërbimet Greke të Emergjencave dhe Shpëtimit

TAP-i është një mbështetës krenar i Shërbimeve Greke të Emergjencave dhe Shpëtimit. Ndër vite, TAP-i ka dhuruar pothuajse 100.000 Euro për pajisje dhe forma të tjera mbështetjeje për:

- **Shërbimin e Mbrojtjes Civile në Evros.** TAP-i ka dhuruar pajisje emergjence dhe pajisje për mbrojtjen personale (PPE), si dhe një mjet fluturues të telekomanduar dhe pa ekuipazh për të lehtësuar kërkimet në zona të vështira.
- **Ekipin Vullnetar të Reagimit ndaj Katastrofave (ETAK) në Kastoria.** TAP-i ka dhuruar materiale emergjence dhe shpëtimi, përfshirë tendat, pajisjet e komunikimit, veshje, barela, defibrilatorë, gjeneratorë energjie dhe litarë.
- **Shërbimin e Zjarrit të Maqedonisë Qendrore.** TAP-i ka dhuruar 59.000 Euro për pajisje të specializuara, si dhe për mirëmbajtjen dhe restaurimin e plotë të kapaciteteve operationale të flotës zjarfikëse në Prefekturën e Maqedonisë Qendrore. TAP-it i është dhënë një Çmim Nderi për kontributin e tij.
- **Ekipin Helen të Shpëtimit.** TAP-i ka dhuruar materiale dhe pajisje për degën në Kavalla të kësaj OJF-je me seli në Selanik, që ndërmer operacione kërkimi dhe shpëtimi që prej vitit 1978.

Pajisjet moderne janë kyçe për garantimin e sigurisë të punonjësve të shpëtimit si dhe personave në rrezik.





Programi ISM në
SHQIPËRI



TAP-i do të mbështesë një gamë të gjerë projektesh në të gjitha komunitetet e përshkuara nga gazsjellësi.

Programi i Investimeve Sociale dhe Mjedisore (ISM) në Shqipëri arrin vlerën e 14 milionë Eurove.

Projektet do të përqendrohen në katër fusha:

- Cilësia e jetës së komuniteteve vendase, duke u përqendruar në rehabilitimin e shkollave
- Ngritja e kapaciteteve në sektorë me rëndësi për komunitetet e përshkuara nga TAP-i
- Jetesa, duke u përqendruar në nismat në bujqësi
- Dhurimet dhe reagimi ndaj emergjencave

Përfaqësuesit e TAP-it janë në bisedime të vazhdueshme me komunitetet vendase dhe të gjitha nivelet e qeverisjes, për të hartuar projekte ISM të rëna dakord bashkërisht, të cilat mbështesin përparësitë e zhvillimit të vetë komunitetit.

Zbuloni disa nga projektet ISM të zbatuara në Shqipëri.

0.1 TAP-i rinovon Ambientet Sportive të Shkollës në Fier

Ambientet sportive të shkollës "Andon Peka" në Fshatin Seman të Fierit ishin në gjendje të rëndë. Në vitin 2015, TAP-i vendosi të sigurojë ambiente tërësisht të rinovuara sportive për të 270 nxënësit e kësaj shkolle dhe për të gjithë komunitetin. Përveç palestrës së shkollës, TAP-i përmirësoi gjithashtu edhe oborrin dhe çatinë e shkollës.

Rehabilitimi i shkollës "Andon Peka" përforcon zotimin e TAP-it për fuqizimin e ambienteve të stërvitjes dhe mësimdhënies. TAP-i mbështeti të gjithë procesin e rinovimit: vlerësimin e gjendjes së shkollës, përgatitjen e planit të rinovimit, përcaktimin e kontraktorit, blerjen e pajisjeve të reja sportive për palestrën, etj.

Punimet e rinovimit zgjatën katër muaj dhe u kryen nga Filipi sh.p.k, një shoqëri shqiptare. Rreth 15 persona u punësuan për këto punime dhe projekti u komisionua në maj të vitit 2015.

Hapja e ambienteve të rinovuara sportive u shënuar me një ceremoni të vogël me pjesëmarrjen e autoriteteve vendore, pjesëtarë të komunitetit vendas dhe përfaqësues të TAP-it. Nxënësit vunë në skenë valle dhe këngë popullore dhe zyrtarët e shkollës përgëzuan përfshirjen e TAP-it në përmirësimin e kushteve sportive.



0.2 Rehabilitimi i Shkollës "7 Dëshmorët" në Roskovec

Shkolla "7 Dëshmorët" gjendet në fshatin Strumë, në Bashkinë e Roskovecit. Kjo shkollë është ndërtuar në vitin 1977 dhe nuk ishte rinovuar asnjëherë që prej asaj periudhe. Falë investimit të TAP-it për rikonstrukcionin e saj, 290 nxënës dhe 14 mësues tashmë përfitojnë nga kushtet moderne të mësimdhënies. Me shtimin e kapacitetit të saj, pritet që edhe 50 nxënës të tjerë të pranohen në këtë shkollë.

Punimet e rehabilitimit të TAP-it u hartuan për të rikonstruktuar tërësisht ndërtesën dykatëshe të shkollës me sipërfaqe të brendshme prej rreth 2.000 m² dhe një sipërfaqe të jashtme prej 2.900 m². Punimet përfshinë instalimin e një sistemi të ri alarmi zjarri dhe shkallë emergjence, duke e bërë këtë një nga shkollat e para në Shqipëri me një sistem evakuimi në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Për më tepër, izolimi i ndërtesës pritet të përmirësojë efikasitetin e energjisë së ndërtesës. Dyert dhe dritaret ekzistuese u zëvendësuan, u instaluan sisteme të reja elektrike, hidraulike dhe shkarkimi dhe u shtua numri i tualeteve.

Rikonstrukcioni i shkollës nisi në qershor të vitit 2017. Projekti u zbatua nga shoqëria shqiptare B-93, dhe u angazhuan më shumë se 120 punonjës. Abkons, kontraktori i TAP-it për Shërbimet e Menaxhimit të Projektit lidhur me zbatimin e Projekteve të Ndërtimit ISM, administroi punimet, duke përfshirë edhe projektimin, mbikëqyrjen, menaxhimin e nënkontraktorëve dhe komisionimin.

Shkolla u komisionua dhe iu dorëzua Bashkisë së Roskovecit në shtator të vitit 2017, në kohë për fillimin e vitit të ri shkollor. Kryeministri, Edi Rama, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Menaxherë të TAP-it dhe zyrtarë të tjerë shqiptarë inauguruan shkollën në nëntor 2017.







0.3 Rehabilitimi i Shkollës “Fuat Babani” në Bilisht

Shkolla e Mesme “Fuat Babani” me më shumë se 800 nxënës të regjistruar, është një nga shkollat më të mëdha në Bilisht, Bashkia Devoll. Gjatë dekadave të fundit, ambientet e shkollës kishin degraduar në mënyrë graduale. Duke qenë se TAP-i kujdeset për nevojat e komuniteteve, ai vendosi të rikonstrukttojë këtë shkollë të rëndësishme. Në shtator të vitit 2017, shkolla e rikonstruktuar hapi dyert për të mirëpritur nxënësit për një vit të ri akademik.

Shkolla përbëhet nga një ndërtesë kryesore dhe nga palestra. Projekti i rikonstruksionit rriti kapacitetin e shkollës duke ndërtuar edhe dy godina të reja, që janë të pajisura me tualete të reja dhe ambiente teknike për pompat e depozitave të ujit dhe sistemin e ngrohjes.

Ambientet e rikonstruktura tashmë kanë termo-izolim efikas, një sistem modern ngrohjeje, ventilimi dhe ajri të kondicionuar (HVAC), si dhe mobilie të reja në klasa. U instaluan gjithashtu edhe një sistem për sigurinë nga zjarri, shkallë emergjence, dyer e dritare të reja, ndërkohë që u rindërtua çatia dhe u shtrinë instalime tërësisht të reja elektrike dhe hidraulike.

Projekti u zbatua nga sipërmarrja e përbashkët midis AD-Star dhe Kefa sh.p.k, që shumicën e punëtorëve të përfshirë e punësoi nga komuniteti vendas. Abkons, kontraktori i TAP-it për Shërbimet e Menaxhimit të Projektit lidhur me zbatimin e Projekteve të Ndërtimit ISM, administroi punimet, përfshirë edhe projektimin, mbikëqyrjen, menaxhimin e nënkontraktorëve dhe komisionimin.

Shkolla u komisionua dhe iu dorëzuar Bashkisë së Devollit në shtator të vitit 2017, gati për fillimin e vitit të ri shkollor.



0.4 Rehabilitimi i Shkollës “Thanas Ikonomi” në Grecalli, Fier

Shkolla “Thanas Ikonomi” gjendet në fshatin Grecalli, Bashkia Fier. E ndërtuar në vitin 1975, shkolla kishte degraduar gradualisht deri në pikën sa disa prej nxënësve nuk e frekuentonin më për shkak të sigurisë. TAP-i vendosi të rehabilitojë të gjitha ambientet e jashtme dhe të brendshme të shkollës. Më shumë se 210 nxënës ndjekin arsimin tashmë në kushte shumë më të mira.

Punimet përfshinë sivatimin e mureve dhe shtrimin e pllakave, zëvendësimin e dritareve dhe dyerve, instalimin e linjave elektrike dhe të internetit, riparimet e tualeteve, etj. Gjithashtu u blenë edhe mobilie të reja.

Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe efikasitetit të energjisë dhe kontrollit të temperaturës. Kjo u arrit përmes izolimit të ndërtesës dykatëshe. Për më tepër, u instaluan edhe shkallët e emergjencës dhe sistemi i sigurisë nga zjarri, duke e bërë këtë një nga shkollat e para në vend që përfiton nga standardet e përmirësuara të sigurisë.

Punimet nisën në prill të vitit 2017 dhe zgjatën katër muaj. Projekti hapi rreth 70 vende pune. Ceremonia e inaugurimit të shkollës së rehabilituar u mbajt në tetor të vitit 2017.

Shoqëria shqiptare Agbes sh.pk. administroi punimet e rehabilitimit, nën mbikëqyrjen e Abkons, kontraktorit të TAP-it për Shërbimet e Menaxhimit të Projektit lidhur me zbatimin e Projekteve të Ndërtimit ISM, përfshirë edhe projektimin, mbikëqyrjen, menaxhimin e nënkontraktorëve dhe komisionimin.





0.5 Programi i Ndërgjegjësimit për Shëndetin dhe Sigurinë Rrugore

Trafiku mbetet një nga çështjet më të rëndësishme të sigurisë në Shqipëri. Në vitin 2016, 269 persona humbën jetën si pasojë e aksidenteve rrugore. Në kuadrin e kësaj situatë, TAP-i nisi një program edukimi dhe ndërgjegjësimi të përqendruar te nxënësit dhe komunitetet përgjatë gjurmës së gazsjellësit.

Përpjekjet e TAP-it për edukim dhe ndërgjegjësim mbi sigurinë rrugore shkojnë përtej lehtësimit të rreziqeve të lidhura me ndërtimin e tubacionit. TAP-i ka si qëllim të përmirësojë kulturën e sigurisë në të gjitha komunitetet vendase, duke ndarë përvojat dhe sjelljet e mira dhe të sigurta. Duke diskutuar sigurinë në shkolla, TAP-i mbështet Ministrinë e Arsimit në ndryshimin e sjelljes dhe në zhvillimin e zakoneve të mira që në moshë të hershme.

Programi i Ndërgjegjësimit për Sigurinë përfshiu:

- 5 tryeza pune me mësues nga 70 shkolla
- 1.232 orë trajnimi për 154 mësues
- 1.851 nxënës të trajnuar nga ekspertët
- 5.811 nxënës të trajnuar nga mësuesit
- 22.986 orë trajnimi për sigurinë rrugore për 7.762 nxënës në 70 shkolla përgjatë gjurmës së transportimit të tubave
- 1.000 punime artistike për temat e SHSM-së (vizatime, ese) të përgatitura nga nxënësit e trajnuar
- 700 pjesëtarë të 18 komuniteteve morën pjesë në trajnimet për sigurinë rrugore
- 82 punonjës nga 8 qendra shëndetësore u trajnuan për ndihmën e shpejtë
- 800 broshura mbi sigurinë u shpërndanë në komunitetet vendase
- 16.000 broshura për sigurinë u shpërndanë në 70 shkolla
- 50 kënde sigurie u instaluan në 50 shkolla.



0.6 Pajisje për të Luftuar Zjarret

Gjatë verës së vitit 2017, thuajse në të gjithë Evropën shpërthyen vatra zjarri. Shqipëria ishte një nga vendet e ndikuara më shumë dhe pati vatra zjarri të raportuara përgjatë gjurmës së gazsjellësit në rrethet e Skraparit, Korçës dhe Beratit.

TAP-i mori një kërkesë zyrtare për mbështetje nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme. TAP-i iu përgjigj thirrjes së autoriteteve shqiptare duke mundësuar fikës zjarri dhe uniforma zjarrfikëse brenda një periudhe të shkurtër kohe.

TAP-i siguroi mjetet e mëposhtme:

- 100 uniforma personale mbrojtëse (përfshirë helmetën, dorezat, çizmet, kapuçin mbrojtës, pantallonat, xhaketat)
- 600 pompa zjarrfikëse shpine.

Pajisjet u mundësuan zjarrfikësve të jenë më efikas gjatë luftës me zjarret si dhe të reduktojnë rrezikun nga nxehtësia. Shërbimet e emergjencave në të gjithë Shqipërinë morën pajisjet në gusht dhe në shtator të vitit 2017.

Duke marrë në konsideratë rrezikun e zjarreve gjatë stinës së verës, në një fazë të dytë, TAP-i në bashkërendim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, do të sigurojë makina zjarrfikëse dhe ambulanca që mund të hyjnë në zonat malore të Shqipërisë.



0.7 Ndërtimi i Urës me Dy Korsi në Çorovodë

Ura kryesore në qytetin shqiptar të Çorovodës ishte e ngushtë, në kushte të rënda dhe ishte e ndërtuar vetëm me një korsi lëvizjeje. Ura mundëson aksesin në spitalin kryesor të Çorovodës dhe pika të tjera turistike në këtë pjesë të Shqipërisë. TAP-i ndërtoi një urë me dy korsi, që tashmë siguron transport më të sigurt që mbështet ekonominë dhe turizmin vendor.

Më shumë se 15.000 banorë të Çorovodës dhe fshatrave përreth, si dhe shumë turistë e përdorin çdo ditë urën e përforcuar. Turizmi, një burim i rëndësishëm të ardhurash për vendasit, gjithashtu përfiton nga ky përmirësim. Shumë turistë e përdorin këtë infrastrukturë gjatë verës, kur vizitojnë pikat natyrore në Shqipërinë jugore, si Kanionet e Lumit Osum. Ura është lidhja e vetme midis pjesëve veriore dhe jugore të Çorovodës.

Punimet e rehabilitimit zgjatën rreth tre muaj. Urës i duhej një strukturë tërësisht e re, koka pilash, si dhe ndërtimin e një korsie të re. Ura u zgjerua në tetë metra e përbërë nga dy korsi me nga tre metra gjerësi dhe dy trotuare nga një metër gjerësi.

Të pranishëm në ceremoninë e inaugurimit të urës në datë 16 tetor 2016 ishin Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta, Kryetari i Bashkisë Çorovodë, Nesim Spahiu, dhe autoritetet vendore.





0.8 Ndërtimi i Platformave Panoramike, Kanioni i Osumit

Vizitat në Kanionin e Osumit, një nga vendet më të bukura shqiptare, ishin të vështira dhe jo të sigurt. TAP-i dhe Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) ndërtuan në partneritet dy platforma panoramike moderne, duke mundësuar akses më të mirë dhe të sigurt për më shumë se 15.000 turistë në vit. Investimi i përgjithshëm arriti një vlerë më shumë se 132.000 Euro dhe rreth 100 persona u punësuan për këtë proces.

Punimet përfshinë ndërtimin e dy ballkoneve panoramike duke instaluar struktura metali të galvanizuar. Veprimtaritë ndërtimore u kryen me kujdes për të shmangur ndikimet në mjedis, dhe për të respektuar strukturën gjeologjike dhe florën e kanionit. Strukturat e reja panoramike mbi Kanionin e Osumit u mundësojnë vizitorëve të shijojnë panoramën e mrekullueshme në mënyrë të sigurt.

TAP-i dhe AADF inauguruan platformat panoramike, të quajtura "Lakorja e Flamurit" dhe "Vrima e Nuses", më 1 qershor 2017. Në ceremoninë e inaugurimit ishin të pranishëm Kryetari i Bashkisë Skrapar, Nesim Spahiu, Bashkëdrejtori Ekzekutiv i AADF-së, Martin Mata, Drejtori për Vendingun i TAP Shqipëri, Shkëlqim Bozgo, si dhe përfaqësues të një sërë organizatave, bizneseve dhe komuniteteve vendase.

Dy strukturat panoramike do t'i lejojnë turistëve që vizitojnë zonën e Skraparit të kenë një pamje nga lart të kanionit dhe mbi të gjitha do t'i mundësojnë atyre akses të sigurt. Me ndërtimin e dy strukturave panoramike, qyteti i Çorovodës dhe zona e Skraparit parashikojnë të tërheqin edhe më shumë turistë përgjatë vitit, duke mbështetur kështu akoma më shumë komunitetet vendase.

PRG*BR Architecture projektoi dy platformat, ndërsa Salillari Sh.p.k. zbatoi punimet e ndërtimit. Të dyja janë shoqëri shqiptare.



0.9 Hapja e Programit të Praktikave Profesionale

TAP-i po zbaton një program praktikash profesionale në Shqipëri me qëllim ofrimin e të rinjve mundësi suksesi edhe pas përfundimit të studimeve të tyre universitare. Gjatë një periudhe prej gjashtë muajsh, një grup i vogël studentësh të talentuar kanë mundësinë të punojnë në departamentet kyçe të projektit dhe të drejtohen nga ekspertë në industrinë energjetike. Raundi i parë i Programit të Praktikave të TAP-it u mbyll me sukses, ndërsa raundi i dytë (korrik – dhjetor 2017) është ende në zbatim.

Praktikantët punojnë në departamente të ndryshme të TAP-it si: financë; dorëzimi i tubacionit; Shëndet, Siguri dhe Mjedis (SHSM); koordinimi i palëve të interesit; blerja, servituti dhe menaxhimi i tokës; kontratat dhe prokurimet; dhe Përgjegjësia Sociale e Korporatës (CSR). Praktikantët përfshihen në punë faktike që lidhet me interesat dhe aftësitë e tyre. Programet e praktikave po shihen gjithnjë e më shumë si një trampolinë drejt punësimit në shoqëri.

TAP-i ka si qëllim të identifikojë, tërheqë dhe mundësisht të mbajë kandidatët më të mirë dhe t'i ndihmojë ata të zhvillojnë karrierën e tyre. Programi është pjesë e trashëgimisë së shoqërisë në Shqipëri. TAP-i është i angazhuar të përforcojë njohuritë e profesionistëve të rinj, duke mbështetur kështu burimet vendore njerëzore në sektorin energjetik shqiptar me zhvillim të vrullshëm.

Programi mbështetet nga disa universitete lider në Shqipëri.



10 Mbështetje për Familjet e Prekura nga Përmbytjet në Otlak

Në vitin 2016, zona e Otlakut, Ura Vajguore, u prek nga përmbytje të rënda. Duke kuptuar nevojat e komunitetit, TAP-i ofroi mbështetjen e tij duke dhuruar paketa emergjence për rreth 220 familje.

11 Ndhimesë gjatë Dimrit të Egër

Gjatë dimrit të egër 2016-2017, TAP-i ndihmoi rreth 1.300 familje nga 100 fshatra përgjatë gjurmës së gazsjellësit dhe më tej. Nisma u zbatua në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe me autoritetet vendore.

Nisma kishte si qëllim mbështetjen e familjeve në nevojë pas reshjeve të mëdha të dëborës. TAP-i dhuroi për çdo familje paketa emergjence me pesë batanije dhe ushqimet bazë. U ndihmuan rreth 6.000 individë gjithsej në Bashkitë Fier, Roskovec, Lushnje, Berat, Ura Vajgurore, Çorovodë, Poliçan, Korçë, Devoll dhe Maliq.

Ëngjellushe Barolli, një nga banoret e Bilishtit tha:

“Dimri është gjithmonë e më i vështirë për familjet e varfra në fshatrat e thella. I jemi mirënjohës TAP-it që mendoi për ne në këtë situatë shumë të vështirë.”

TAP-i nisi të punojë me Kryqin e Kuq Shqiptar në vitin 2015, kur dy organizatat u bashkuan për të mbështetur familjet e prekura nga përmbytjet në rajonin e Beratit.





Programi ISM në

ITALI



Në bashkëpunim me palët vendore dhe rajonale të interesit, TAP-i ka hartuar një program të përshtatur investimesh sociale dhe mjedisore (ISM).

TAP-i po zbaton projekte ISM me vlerë për një zhvillim të qëndrueshëm të Salentos dhe Pulias dhe për të mbështetur ngritjen e aftësive dhe edukimin e ekselencës.

Projektet do të përqendrohen në:

- Jetesën, duke theksuar turizmin, bujqësinë dhe peshkimin;
- Menaxhimin mjedisor, duke theksuar çështje të lidhura me turizmin, bujqësinë dhe mjedisin detar;
- Cilësinë e jetës së komunitetit, duke theksuar shërbimet dhe infrastrukturën.

Zbuloni disa nga Projektet ISM të zbatuara në Itali.



0.1 TAP Start: Grante për Organizatat Vendore

TAP Start mbështet idetë e komuniteteve vendase në provincën e Leçes. Programi i drejtuar nga TAP ofron disa grante të vogla për organizatat jofitimprurëse që zbatojnë projekte në fushat e sportit, kulturës, mjedisit dhe çështjeve sociale. TAP-i ka investuar një shumë prej 200.000 Euro në vitin 2016 për shtatë projekte vendore, që tashmë po zbatohen nga shoqatat vendore të Meledunjos. Për edicionin e dytë të TAP Start në vitin 2017, janë mundësuar 400.000 Euro, duke shtrirë zonën e aplikimeve në të gjithë provincën e Leçes.

Stratcultour, një nga projektet e financuara në kuadrin e programit të investimit për vitin 2016, organizoi tre turne edukimi në dy shkolla të Leçes në mars të vitit 2017. Shoqata njohu rreth 250 nxënës dhe mësues me pikat e interesit vendas, përfshirë fshatin Akaja me muret e fortifikuara dhe kështjellën e tij; zonën arkeologjike të 'Roca vecchia'; dhe shpellën Poesia (një shpellë detare që përfaqëson një vend lutjeje për Mesapët, një fis i lashtë vendas). TAP-i mbështeti projektin duke qenë se ai ofronte ndërgjegjësim për pikat kulturore që nuk njiheshin nga popullata vendase. Për më tepër, nisma fuqizoi aftësitë e komunitetit vendas, sidomos brezave të rinj.

Në kuadrin e një projekti tjetër, në Meledunjo u organizua një tryezë pune tre ditore me operatorë turistikë ndërkombëtarë. Aktiviteti kishte si qëllim të rriste numrin e turistëve që vijnë në rajon dhe të tërhiqte vizitorë të huaj.

Thirrja për aplikim me projekte për edicionin e dytë të TAP Start u hap në 1 qershor dhe u mbyll në 31 gusht 2017. I gjithë informacioni i nevojshëm dhe dokumentacioni për aplikim u mundësuan në adresën: www.tapstart.it

Pas fazës së dorëzimit të aplikimeve, TAP-i dhe një panel i përbërë nga ekspertë të pavarur në sektorë të ndryshëm të programit, vlerësojnë dhe hartojnë një listë të shkurtër me projekte fituese.

Me këtë thirrje, TAP-i mbështet idetë më të mira nga organizata që i kanë rrënjët në komunitetin vendas. Duke përdorur një qasje nga poshtë-lart, TAP-i synon të japë kontribut konkret për rritjen ekonomike dhe sociale të zonës.

0.2 MENA: Trajnimi për Menaxhim Restoranti

Përmes programit MENA, 15 pronarë dhe menaxherë restorantesh në zonën e Leçes patën mundësinë të marrin pjesë me stafin e tyre në një trajnim të nivelit të lartë për menaxhim restoranti, teknika gatimi dhe transformimin e produkteve ushqimore. Projekti që u zbatua në periudhën janar-prill 2017 solli së bashku kuzhinierë të nivelit të lartë dhe pronarë e menaxherë të restoranteve vendase, duke mbështetur kështu ekonominë dhe turizmin vendor.

Në kuadrin e këtij Programi ISM, TAP-i po mbështet sektorin e ushqimit dhe pijeve, që është një element kyç i ofertës turistike në Itali. Turizmi jep një kontribut madhor për ekonominë vendore. TAP-i dëshiron të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë vendore, duke përmirësuar jetesën e komuniteteve vendase në mënyrë që të jetë e qëndrueshme, të përdorë asetet vendore dhe të theksojë trashëgiminë vendore.

MENA (ose Masteri i Ekselencës në Ushqim të Ri) u ideua për të përmirësuar cilësinë e shërbimit në sektorët e turizmit dhe ushqimit. 15 pronarë dhe menaxherë restorantesh nga Provinca e Leçes, duke përfshirë Bashkinë Meledunjo dhe të tjera nga zona e projektit, morën pjesë në 136 orë module kurse që përfshinin: menaxhimin dhe administrimin e një biznesi katering, degustimin e verës dhe vajit, shërbimin dhe receptionin, intolerancën ndaj ushqimeve, etj. Kursi kishte gjithashtu edhe vizita të programuara në restorante të nivelit të lartë, në taverna tradicionale dhe vreshta që prodhojnë verë, për të parë në terren përvojën e bizneseve të suksesshme.

Për më tepër, tre pjesëmarrësit më të mirë të kursit u këshilluan në mënyrë individuale për të rrijtë konceptet e tyre për restorantin, duke përfshirë këshilla për përmirësimin e menysë dhe mbajtjen e stafit në punë.

MENA u hartua së bashku me RP Consulting, një agjenci komunikimi dhe marketingu nga Apulia, e specializuar në shërbimet e ushqimit dhe pijeve dhe në bashkëpunim me partnerë të rëndësishëm, duke përfshirë Fondacionin Italian të Somelierëve, Shoqatën Donne del vino Puglia (shoqata e grave verë prodhuese), Akademinë Bar Project, dhe H.Q.F Quality Food.

TAP-i shpalli thirrjen për aplikantë në tetor të vitit 2016. Thirrja për aplikime u mbështet nga një fushatë reklamash që u përqendrua në zonën e Leçes, që përfshiu një aktivitet promovues, reklama në gazeta, në internet, në rrjetet sociale, dhe një faqe të posaçme interneti. www.mena-masteritap.it

Në dhjetor të vitit 2017 u shpall një edicion i dytë i trajnimit profesional MENA. TAP-i do të organizojë një kurs ekselence me 140 orë të përkushtuar për pronarët, menaxherët dhe profesionistët vendas të restoranteve, që punojnë në sektorin e ushqimit/industrisë ushqimore. Trajnimi i ri do të nisë në janar të vitit 2018. Për detaje të tjera, ju lutemi vizitoni faqen www.mena-masteritap.it



mena!

MASTER d'ECCELLENZA per la NUOVA ALIMENTAZIONE



0.3 Reduktimi i Ndotjes Detare – Libera il Mare

Programi i ndotjes detare të TAP-it synon, përmes një sërë veprimtarish shkencore, operacionale dhe ndërgjegjësuere, të studiojë dhe të largojë ndotjet detare në një brez prej rreth 20 km në bregdetin e Adriatikut (Bashkitë Vernole, Leçe dhe Meledunjo). Projekti është hartuar me CoNISMa (Konsorciumi Ndëruniversitar për Shkencat Detare), përmes njësisë së tij të kërkimit në Departamentin e Biologjisë dhe Zoologjisë Detare në Universitetin e Salentos. Faza paraprake e studimit, të cilën TAP-i e mbështeti me një investim prej 65.000 Euro, u ndërmor në periudhën shkurt – korrik 2017. Programi shumëvjeçar që parashikon një gamë të gjerë veprimtarish, si mbledhja dhe largimi i ndotjes detare, fushatat e ndërgjegjësimit dhe kërkimet shkencore për t'iu kundërvënë mbetjeve plastike në plazhe dhe në shtratin e detit, është aktualisht në fazën e hartimit.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të reduktojë ndotjen detare si dhe të lehtësojë rreziqet që i kanosen ekosistemeve detare.


Peshkatarët dhe sipërmarrësit e turizmit vendor, banorë të komunitetit të Meledunjos dhe turistë që zgjedhin Meledunjon si destinacionin e tyre të pushimeve, do të përfitojnë nga programi i Ndotjes Detare.

Programi përqendrohet në:

- Krijimin e njohurive rreth modeleve të mbetjeve detare përmes kërkimeve të shënjestruara.
- Rritjen e ndërgjegjësimit për mbetjet detare përmes fushatave të ndërgjegjësimit për menaxhimin mjedisor dhe përfshirjen e palëve të interesit.
- Anketimin dhe – në një moment të dytë – largimin e mbetjeve detare nga plazhet, bregdetin guror dhe shtratin e detit.
- Mbështetjen afatgjatë për menaxhimin e mbetjeve urbane, duke përgatitur udhëzues për autoritetet vendore dhe palët përkatëse të interesit.

TAP-i dhe partneri i tij ndërmorën fazën paraprake të programit në gjysmën e parë të vitit 2017. Hapi i parë kishte si qëllim të vlerësonte mbetjet detare në zonën e projektit. Rezultatet e anketimeve cilësore dhe sasore siguruan një vlerësim të sasisë së mbetjeve detare dhe një peshë të përafërt të këtyre mbetjeve. Studimi pilot shërben si një pikë fillese për planifikimin e programeve të përshtatshme të monitorimit të mbetjeve detare në vitet në vijim.

Faza paraprake përfshiu gjithashtu një fushat ndërgjegjësimi në shkollat vendore. Gjatë klasave ndërvepruese, 320 fëmijë morën informacion rreth mjedisit detar dhe kërcënimeve të shkaktuara nga ndotja detare. Nxënësit gjithashtu mësuan rreth rëndësisë së parandalimit të ndotjes detare. Në klasa u shpërndanë edhe vegla të veçanta dhe materiale informuese.



Libera il Mare

Pulizia delle spiagge e cultura ambientale



0.4 Akademia TAP: kurse falas për komunitetet vendore

Me qëllim përforcimin e aftësive të kërkuara për biznes, TAP-i mbështet kurse falas për komunitetet vendase në Leçe. Duke u regjistruar në Akademinë TAP, rreth 50 pjesëmarrës mund të përmirësojnë njohuritë e tyre të gjuhës angleze, shkencave kompjuterike apo marketingut përmes mediave sociale, që janë kompetenca që kërkohen gjithnjë e më shumë në tregun vendor të punës. Akademi TAP është një program për rritjen e kapaciteteve dhe është tashmë po zhvillon edicionin e saj të dytë.

Pas suksesit të raundit të parë të kurseve falas në anglisht dhe TIK (teknologjia e informacionit dhe komunikimit) /shkenca kompjuterike, të organizuar në prill të vitit 2017, TAP-i zgjeroi fushëveprimin e programit duke përfshirë marketingun përmes mediave sociale, një element kyç ky që ndihmon bizneset vendore të zgjerojnë klientelën e tyre.

Kurset e TIK/shkencave kompjuterike kanë module bazë dhe të avancuara dhe i përgatisin pjesëmarrësit për provimet e Licensës Evropiane të Shfrytëzimit të Kompjuterit (ECDL).

Kurset e gjuhës angleze janë të ndara në kurse të gjuhës bazë dhe anglishtes për industrinë e turizmit (niveli mesatar).

Kurset ofrohen nga shoqëri të mirënjohura vendore dhe institucione formimi.

The poster is divided into two main sections. The left section has a blue background and features the text 'corsi GRATUITI di INFORMATICA' in large white letters. Below this, a white box contains two bullet points: '• preparazione ECDL' (with 'European Computer Driving Licence' in smaller text) and '• social media marketing'. Below that, the word 'INGLESE' is written in large white letters, followed by another white box with two bullet points: '• corso base' and '• inglese per il turismo'. The right section has a white background and features the 'TAP ACADEMY' logo in green and blue. Below the logo is the tagline 'Adesso imparare è più facile.' and three icons with text: a checkmark icon for 'iscrizioni fino a esaurimento posti dall'11 settembre', a group of people icon for 'aperti a tutti I cittadini della Provincia di Lecce', and a phone icon for 'per informazioni 0832 834981 0832 249721'. At the bottom right, there is a logo for 'Trans Adriatic Pipeline' and the website 'www.tap-og.it'.



Trans Adriatic Pipeline AG
Lindenstrasse 2
6340 Baar, Switzerland
T: +41 41 747 3400
F: +41 41 747 3401
E: enquiries@tap-ag.com

www.tap-ag.com

Botimi: Dhjetor 2017